



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

Përdorimi i kuizeve në platformën Moodle për të përmirësuar të nxënit e nxënësve në lëndën e TIK-ut

Autori:

Lendita Surdulli – Shabani

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Kyvete Shatri

Programi:

Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut

Viti akademik:

2025/2026

Hyrja

Moodle, si një platformë për menaxhimin e të nxënit, ofron mundësi të shumta për të transformuar mësimdhënien, duke përfshirë edhe funksionalitetin e kuizeve interaktive. Përdorimi i kuizeve në këtë platformë nuk kufizohet vetëm në testim, por shërben edhe si një mjet për përforsim të njohurive, rritje të angazhimit, si dhe nxitje të mendimit kritik. Kjo formë e vlerësimit, e kombinuar me feedback të menjëhershëm, mund të sjellë përfitime të konsiderueshme në procesin e të nxënit.

Përvoja praktike në klasë ka treguar se shumë nxënës reagojnë pozitivisht ndaj qasjeve më interaktive dhe teknologjike, veçanërisht kur mjetet e përdorura lidhen me mënyrën e tyre të të mësuarit. Duke marrë parasysh këto ndryshime në stilin e të nxënit të gjeneratave të reja, është e nevojshme që edhe mësimdhënësit të përshtatin metodat e tyre. Ky studim paraqet një përpjekje për të kuptuar më mirë se si përdorimi i kuizeve në Moodle ndikon në përvetësimin e njohurive dhe angazhimin e nxënësve në lëndën e TIK, me qëllim ofrimin e një mësimi më efektiv dhe të përshtatur me nevojat bashkëkohore të arsimit.

Duke pasur parasysh këto përfitime, ky studim synon të analizojë në mënyrë konkrete se si përdorimi i kuizeve në Moodle ndikon në përvetësimin e njohurive në lëndën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Qëllimi është të vlerësohet nëse një qasje e tillë ndihmon jo vetëm në rritjen e rezultateve akademike, por edhe në angazhimin e nxënësve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në mësim. Përmes krahasimit të dy grupeve, njëri që përdor kuize digjitale dhe tjetri që ndjek metoda hulumtimi pa përdorim të teknologjisë ofron një pasqyrë të qartë mbi avantazhet dhe sfidat e kësaj metode.

Metodologjia

Për realizimin e këtij hulumtimi, është zbatuar një qasje e kombinuar metodologjike që përfshin si komponentët sasiorë ashtu edhe ato cilësorë, me qëllim që të ofrojmë një pasqyrim gjithëpërfshirës mbi ndikimin e përdorimit të kuizeve. Dizajni i studimit është kuazi-eksperimental, i cili është i përshtatshëm për situatat kur nuk është e mundur ndarja plotësisht e rastësishme e pjesëmarrësve në grupe. Në kuadër të këtij modeli, janë përfshirë dy grupe nxënësish: Grupi eksperimental, angazhohet në kuize të strukturuar përmes platformës Moodle, dhe Grupi kontrollues, i cili vazhdon me vlerësimin përmes metodave tradicionale. Përmes krahasimit ndërmjet performancës akademike dhe nivelit të angazhimit të të dy grupeve, hulumtimi synon të identifikojë ndikimin real të përdorimit të Moodle-it si mjet vlerësimi. Të dhënat janë mbledhur përmes testeve para dhe pas ndërhyrjes (pre-test dhe post-test), si dhe përmes pyetësorit për perceptimet e nxënësve dhe analizës cilësore të komenteve të tyre.

Rezultatet kryesore

Rezultatet e këtij studimi ofrojnë përgjigje të drejtpërdrejta dhe të argumentuara ndaj pyetjeve hulumtuese të parashtruara në fillim të punimit. Në lidhje me pyetjen e parë të hulumtimit se *çfarë ndikimi ka përdorimi i kuizeve në Moodle në përvetësimin e përmbajtjes mësimore dhe rritjen e interaktivitetit*, analizat tregojnë se kjo qasje përmirëson ndjeshëm rezultatet akademike dhe angazhimin e nxënësve. Po ashtu, për pyetjen e dytë hulumtuese që lidhet me *përparësitë e kuizeve në Moodle krahasuar me metodat pa përdorim të teknologjisë së vlerësimit*, rezultatet dëshmojnë se vlerësimi digjital është më efektiv, më objektiv dhe më motivues. Këto gjetje tregojnë se integrimi i teknologjisë në procesin mësimor, kur realizohet në mënyrë të strukturuar pedagogjikut, kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së të nxënësve.

Diskutimi

Analiza e të dhënave nga pyetësi për grupin eksperimental dhe lista e kontrollit tregon se nxënësit që mësuan përmes kuizeve digjitale shfaqën nivele më të larta motivimi, interesi dhe pjesëmarrjeje aktive. Këto rezultate sugjerojnë se përdorimi i Moodle ka ndikuar pozitivisht në krijimin e një klime më bashkëpunuese dhe më përfshirëse në klasë, duke e zhvendosur fokusin nga mësimi frontal drejt të nxënësve aktiv.

Nga aspekti i vlerësimit, kuizet në Moodle kanë mundësuar një proces më objektiv dhe më të standardizuar të matjes së njohurive. Automatizimi i vlerësimit redukton subjektivitetin e mësimit dhe siguron barazi në vlerësim për të gjithë nxënësit. Për më tepër, shpejtësia e vlerësimit dhe feedback-u i menjëhershëm e bëjnë procesin më efikas dhe më transparent.

Këto gjetje janë në përputhje me studimet e Gikandi et al. (2011), të cilët argumentojnë se përdorimi i simulatorëve dhe mjeteve digjitale të vlerësimit përmirëson ndjeshëm kuptueshmërinë konceptuale dhe performancën akademike. Po ashtu, (Anderson, 2001) thekson se vlerësimi interaktiv rrit performancën në testime dhe ndihmon në qëndrueshmërinë e njohurive të fituara.

Rekomandime

- **Integrimi sistematik i kuizeve digjitale në mësim** – Kuizet në Moodle duhet të përdoren jo vetëm si mjet vlerësimi, por edhe si instrument formativ që mbështet të nxënësit aktiv dhe ndërveprimin në të gjitha lëndët, jo vetëm në TIK.
- **Trajnim i vazhdueshëm për mësuesit** – Mësuesit duhet të trajnohen mbi mënyrat pedagogjike efektive për përdorimin e platformave digjitale, duke përfshirë krijimin e kuizeve, ofrimin e feedback-ut dhe monitorimin e progresit të nxënësve.
- **Personalizimi i kuizeve** – Kuizet mund të strukturohen për të përshtatur nivelet e njohurive të nxënësve, duke rritur sfidën individuale dhe duke mbështetur progresin personal të secilit nxënësi.
- **Përdorimi i feedback-ut të menjëhershëm** – Platforma Moodle duhet të shfrytëzohet për të ofruar reagim të menjëhershëm mbi përgjigjet e nxënësve, duke nxitur vetëvlerësimin dhe korrigjimin e gabimeve në kohë reale.
- **Zgjerimi i studimeve të ardhshme** – Sugjerohet përfshirja e niveleve të ndryshme arsimore, shkollave të ndryshme dhe një mostre më të madhe nxënësish për të marrë një pasqyrë më të gjerë të efektivitetit të kuizeve digjitale.

- **Analizimi i ndikimit afatgjatë** – Studimet e ardhshme mund të vlerësojnë ndikimin e kuizeve digjitale në zhvillimin e kompetencave akademike, digjitale dhe aftësive kritike të mendimit në periudha më të gjata kohore.
- **Promovimi i bashkëpunimit në mes të nxënësve** – Kuizet mund të përdoren për aktivitete grupore dhe diskutime, duke forcuar bashkëpunimin dhe zhvillimin e aftësive sociale mes nxënësve.

Fjalë kyçe: *Interaktiv, kuize, Moodle, TIK, të nxënit.*



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Extended Abstract

Title of the Thesis:

The Use of Quizzes on the Moodle Platform to Improve Students' Learning in the ICT Subject

Author:

Lendita Surdulli – Shabani

Mentor:

Assoc. Prof. Dr. Kyvete Shatri

Program:

Master of Subject Teaching: Teaching of Technology and ICT

Academic Year:

2025/2026

Introduction

Moodle, as a Learning Management System (LMS), offers numerous opportunities to transform teaching, including the functionality of interactive quizzes. The use of quizzes on this platform is not limited to assessment only, but also serves as a tool for reinforcing knowledge, increasing engagement, and fostering critical thinking. This form of assessment, combined with immediate feedback, can bring significant benefits to the learning process.

Practical classroom experience has shown that many students respond positively to more interactive and technology-based approaches, especially when the tools used align with their learning styles. Considering these changes in the learning styles of new generations, it is essential for teachers to adapt their teaching methods accordingly. This study represents an effort to better understand how the use of quizzes in Moodle affects knowledge acquisition and student engagement in the ICT subject, with the aim of providing more effective teaching tailored to contemporary educational needs.

Taking these benefits into account, this study aims to specifically analyze how the use of quizzes in Moodle influences knowledge acquisition in the subject of Information and Communication Technology (ICT). The objective is to evaluate whether such an approach contributes not only to improved academic performance but also to increased student engagement and active participation in learning. By comparing two groups—one using digital quizzes and the other following traditional, non-technology-based methods—the study provides a clear overview of the advantages and challenges of this approach.

Methodology

To conduct this research, a mixed-methods approach was applied, incorporating both quantitative and qualitative components in order to provide a comprehensive overview of the impact of quiz usage. The study design is quasi-experimental, which is suitable in situations where full random assignment of participants is not feasible.

Within this framework, two groups of students were included: the experimental group, which engaged in structured quizzes through the Moodle platform, and the control group, which continued with traditional assessment methods. By comparing academic performance and engagement levels between the two groups, the study aims to identify the actual impact of Moodle as an assessment tool.

Data were collected through pre-test and post-test assessments, as well as through student perception questionnaires and qualitative analysis of their feedback.

Main Findings

The results of this study provide direct and well-supported answers to the research questions posed at the beginning. Regarding the first research question—what impact the use of Moodle quizzes has on knowledge acquisition and the increase of interactivity—the analysis shows that this approach significantly improves both academic performance and student engagement.

Regarding the second research question, which addresses the advantages of Moodle quizzes compared to non-technology-based assessment methods, the findings demonstrate that digital assessment is more effective, more objective, and more motivating. These results indicate that the integration of technology into the teaching process, when implemented in a pedagogically structured manner, directly contributes to improving the quality of learning.

Discussion

The analysis of questionnaire data from the experimental group and the observation checklist indicates that students who learned through digital quizzes demonstrated higher levels of motivation, interest, and active participation. These results suggest that the use of Moodle has positively influenced the creation of a more collaborative and inclusive classroom environment, shifting the focus from teacher-centered instruction to active learning.

From an assessment perspective, Moodle quizzes have enabled a more objective and standardized process of measuring knowledge. The automation of assessment reduces teacher subjectivity and ensures fairness for all students. Furthermore, the speed of evaluation and the provision of immediate feedback make the process more efficient and transparent.

These findings are consistent with studies by Gikandi et al. (2011), who argue that the use of simulations and digital assessment tools significantly improves conceptual understanding and academic performance. Similarly, Anderson (2001) emphasizes that interactive assessment enhances test performance and supports the retention of acquired knowledge.

Recommendations

- **Systematic integration of digital quizzes in teaching** – Moodle quizzes should be used not only as an assessment tool but also as a formative instrument that supports active learning and interaction across all subjects, not only ICT.
- **Continuous teacher training** – Teachers should be trained in pedagogically effective ways of using digital platforms, including quiz design, providing feedback, and monitoring student progress.
- **Quiz personalization** – Quizzes can be structured to match students' knowledge levels, increasing individual challenge and supporting personal learning progress.
- **Use of immediate feedback** – Moodle should be utilized to provide instant feedback on student responses, encouraging self-assessment and real-time error correction.
- **Expansion of future studies** – Future research should include different educational levels, various schools, and larger student samples to provide a broader perspective on the effectiveness of digital quizzes.
- **Analysis of long-term impact** – Future studies may evaluate the long-term effects of digital quizzes on academic, digital, and critical thinking competencies.
- **Promotion of student collaboration** – Quizzes can be used for group activities and discussions, strengthening collaboration and social skill development among students.

Keywords: Interactivity, quizzes, Moodle, ICT, learning.